

UDHËZIM
Nr. 4, datë 18.3.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.2.2022,
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”; të pikës 5, të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV bëhen ndryshimet si më poshtë.

a) pas paragrafit të parë, shprehja “25.3.2022” zëvendësohet me shprehjen: “30.3.2022, ndërsa për masën mbështetëse nr. 10, deri më datë 29.4.2022”;

b) në pikën 1, “Aplikimi *online*”, shkronja “e” formulohet si vijon:

“Të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik/juridik që kryejnë aktivitetet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para përfitimit të financimit duhet të kenë plotësuar/përditësuar Regjistrin e Fermës pranë AREB-it”.

2. Në kreun X/III bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në pikën 1, fjalia “Të gjithë aplikantët, para aplikimit duhet të plotësojnë/përditësojnë Regjistrin e Fermës” zëvendësohet me formulimin “Të gjithë aplikantët, para pajisjes me kartën e naftës duhet të kenë plotësuar/përditësuar Regjistrin e Fermës pranë AREB-it”;

b) pika 3 zëvendësohet me formulimin “Periudha e aplikimit është nga data 25.2.2022 deri në datën 30.3.2022”;

c) pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me formulimin si vijon:

“Në rastet kur gjatë kontrollit administrativ evidentohen aplikime identike me ato të vitit 2021 (të realizuara nga i njëjti aplikant dhe me të njëjtin dokumentacion pronësie të tokës - certifikatë pronësie/APTP) mund të konsiderohet i vlefshëm konfirmimi përkatës i bërë nga ASHK/NJVV në vitin 2021”.

3. Në kreun X/IV bëhen ndryshimet si vijon:

a) pika 8 zëvendësohet me formulimin “Gjatë procesit të kontrollit administrativ përgatiten lista pjesore, ndërsa në përfundim të tij përgatitet lista përfundimtare e aplikimeve të miratuara, si dhe lista përfundimtare e aplikimeve të skualifikuara”;

b) pika 11 zëvendësohet me formulimin “Listat pjesore të përfituesve dhe lista përfundimtare e përfituesve me masën përkatëse të përlogaritur të naftës për subjektet përfituese publikohet në faqen zyrtare të internetit të AZHBR-së”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Frida Krifca

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj